



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

---

**P nr. 466/14**

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit M.L , sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II. nr.670/14 të dt.16.6.2014, për shkak të veprës penale : të vetëgjyqësisë nga neni 418 par 1 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit M. L. dhe të prokurorit të shtetit Muharrem Bajraktari me dt.12.5.2017 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

**AKTGJYKIM**

**I pandehuri M. L. i lindur me dt.27.2.1949 në C. V K. P, tani me vendbanim në P rruga T. Sh, i biri i M. dhe nënës D. e gjinisë K, Serb , Shtetas i Republikës së Serbisë , kinse i pa dënuar, gjendet në liri**

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

Me dt. 19.10.2013 , në kohë të pacaktuar , në Pejë , i pandehuri M. në mënyrë arbitrare ushtron të drejtën që mendon se i takon në vend që ti drejtohet organit kompetentë, në atë mënyrë që i pandehuri duke qenë në pozitën e ndërmjetësuesit për shitblerjen e patundshmërisë të të dëmtuarit M. L , pasi që kishte shitur një parcelë të tokës e cila gjendet në fshatin B, në vlerë prej 7000 euro, me ç ‘rast shumë prej 2000 euro ia kishte dorëzuar të dëmtuarit , ndërsa shumë prej 5000 euro e kishte ndaluar me arsyetimin se kjo shumë i takon sipas marrëveshjes të përpiluar me dt. 07.10.2012 .

-me çka ka kryer veprë penale: të vetë gjyqësisë nga neni 418 par 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata të pandehurës konform nenit 41, 85, 86 dhe nenit 418 par 1 të KPK-së I SHQIPTON

**VËREJTJE GJYQËSORE**

Me të cilën të pandehurit i behët me dije se ka kryer veprë të dëmshme dhe të rrezikshme që përbënë veprë penale për të cilën nëse ai sërish e përsëritë gjykata do ti shqiptoi sanksion më të rëndë penal.

I pandehuri për shkak të gjendjes së varfër ekonomike lirohet nga pagimi i s paushallit gjyqësorë

Shpenzime procedurale nuk ka pasur .

I dëmtuari për realizimin eventual e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzime procedurale nuk ka pasur .

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.16.6.2014 kundër të pandehurit M. L , ka ngritë aktakuzë PP. nr.670/14, për vepre penale : të vetëgjyqësisë nga neni 418 par 1 të KPK-së duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin gjyqësorë pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimit përkatësisht të mos pranimit të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të të pandehurit , i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë!.

## **Në fjalën përfundimtare palët kanë deklaruar :**

### **Prokurori i shtetit :**

Meqenëse i pandehuri bëri pranimin e fajësisë i cili pranim mbështet edhe në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës , i propozoj gjykatës që i njëjtit të shpallet fajtorë të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në pagimin e shpenzimeve procedurale. Si rrethanë lehtësuese i propozoj gjykatës që me rastin e vendosjes për lartësinë dhe llojin e dënimit ti ketë parasysh pranimin e fajësisë , pendimin e sinqertë , gjendjen e rëndë ekonomike , moshën e shtyrë .

### **I pandehuri:**

Ndihem fajtorë për veprë penale e cila me vihet në barrë .Kamë gjendjen shumë të rëndë ekonomike . Lus gjykatën që të më ndihmoj.

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e sinqertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, pa dënueshmërinë e mëparshme, gjendjen e varfër ekonomike , moshën e shtyrë dhe kësisoj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 453 të KPPRK-së

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil është marrë konform nenit 463 të KPPRK-së .

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë. 12.5.2017.

Sekretarja juridike  
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari  
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet  
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga  
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë  
E përmes kësaj Gjykate .